



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 7, paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr.10/03 prill 2019), nenit 24, dhe nenit 25 të Rregullores QRK nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 52, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, dhe kërkesës nr. 14-156/0-206744/22, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.12.2022, mori këtë

**V E N D I M**  
**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**  
**ODËS SË PROFESIONISTËVE SHËNDETËSORË**

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, Odës së Professionistëve Shëndetësorë.
- II. Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën I të këtij vendimi, është:
  1. Pjesa e parcelës kadastrale, nr. 00535-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 12412 m<sup>2</sup>, jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 400 m<sup>2</sup>, me kulturë arë e klasës së (6) gjashtë, Certifikata e pronësisë nr. P- 71914075-00535-0, Zona kadastrale Çagllavicë, në pronësi të Komunës së Prishtinës.
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është për ndërtimin e objektit të Odave të Professionistëve Shëndetësorë.
- IV. Afati kohor për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është për 99 vjet.
- V. Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.
- VII. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.

- VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.
- IX. Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë:
- kërkesa,
  - skica 3D,
  - certifikata e pronës dhe
  - kopja e planit.
- X. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-463/06-277181/22, më 29.12.2022

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Fehmi Kupina



## Arsyetim

Komuna e Prishtinës ka pranuar kërkesën zyrtare, nr. 14-156/0-206744/22, dt. 20.09.2022, nga ministri i Shëndetësisë, për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim, për Odën e Profesionistëve Shëndetësorë të Kosovës, në bazë të Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Dukatës së Luksemburgut, e ratifikuar në Parlamentin e Republikës së Kosovës dhe Dekretuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës. Komuna e Prishtinës e ka shqyrtuar këtë kërkesë e cila buron nga kjo Marrëveshje ndërkombëtare dhe Drejtoria e Planifikimit Strategjik, ka propozuar që në bazë të Planit rregullues “Prishtina e Re - Zona Qendër”, Tërësia G, Zonë për shfrytëzim shoqëror, t’ia ndajë një pjesë të parcelës 535-0, ZK Çagllavicë, e cila sipas dokumenteve të planifikimit hapësinorë është e paraparë për ndërtesa me karakter publik.

Në bazë të propozimit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, për Odën e Profesionistëve Shëndetësorë, është propozuar zgjidhja urbane, sipas së cilës ky objekt me karakter publik do të ketë 2000 m<sup>2</sup>, dhe do ta ketë shputën 400 m<sup>2</sup>.

Afati kohor për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij Vendimi, është për 99 vjet. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës komunale, do të caktohen me kontratë të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe shfrytëzuesit.

Drejtorja e Pronës e ka shqyrtuar kërkesën e lartcekur, për dhënie në shfrytëzim të pjesës së parcelës kadastrale, e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-71914075-535-0, Zona kadastrale Çagllavicë, për ndërtimin e Odave të Profesionistëve Shëndetësorë, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimore prej 2000 m<sup>2</sup> ( shputa 400 m<sup>2</sup> ).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore si në pjesën hyrëse të këtij Vendimi, kërkesës nr. 14-156/0-206744/22, nga ministri i Shëndetësisë dhe në shkresat e lëndës u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.